



Republika e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO



Republika Kosovo / Republic of Kosovo

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA RAHOVEC
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Odholjenje za Poljoprivredu Šumarstvo i Razvoj

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Nr. I prot.
Br. prot.

231

Më

13.07.2026

Dt.

RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

INFORMATË

Janar – Qershorë - 2026



Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	3
Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars	3
Aktivitetet në muajin janar	4
Aktivitetet në muajin shkurt	5
Aktivitetet në muajin mars	8
Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor	9
Aktivitetet në muajin prill	9
Aktivitetet në muajin Maj	11
Projektet e investimeve kapitale	14
Rregullimi i Rrugëve Fushore	14
Pastrimi i Përrenjëve	15
Kanalet Kulluese	16
Depo Bujqësore	17
PËRFUNDIM	19

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2026, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve.

Gjatë këtij viti, përveç aktiviteteve të planifikuara, Komuna është përballur edhe me vërshime në disa zona të territorit të saj. Vërshimet e datave 5, 6 dhe 7 janar kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme, si në sektorin e bujqësisë, duke dëmtuar të mbjellat e fermerëve, ashtu edhe në infrastrukturën rrugore fushore, përfshirë rrugët, urat dhe përroskat.

Për shkak të gjendjes së krijuar, Drejtoria ka formuar një fazë emergjente të ndërhyrjes me qëllim sanimin dhe rikthimin në funksion të rrugëve fushore, urave dhe infrastrukturës tjetër të dëmtuar, duke ndërmarrë veprimet e nevojshme për lehtësimin e qarkullimit dhe mbështetjen e komunitetit të prekur.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

Aktivitetet e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR), gjatë periudhës raportuese janë realizuar një sërë aktiviteteve dhe shërbimesh në funksion të mbështetjes së fermerëve dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë.

Drejtorja ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme shërbime administrative dhe profesionale për qytetarët, duke përfshirë pranimin dhe trajtimin e kërkesave të ndryshme, si dhe lëshimin e dokumenteve dhe ofrimin e shërbimeve, ndër të cilat:

- lëshimin e vërtetimeve për fermerë, me të cilat dëshmohet statusi i tyre si prodhues bujqësorë;
- lëshimin e Numrit Identifikues të Fermës (NIF);
- shqyrtimin dhe procedimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore;
- vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë;
- si dhe shërbime të tjera në përputhje me kompetencat e Drejtorisë.

Përveç aktiviteteve të rregullta administrative, gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe aktivitete të rëndësishme në kuadër të programeve dhe projekteve të Drejtorisë. Këto aktivitete janë paraqitur në vijim të informatës sipas periudhës kohore në të cilën janë zhvilluar, duke përfshirë projektet mbështetëse për fermerët, aktivitetet zhvillimore dhe angazhimet e tjera në sektorin e bujqësisë.

Aktivitet në muajin janar

Subvencionimi i sektorit të blegtorisë nga MBPZHR

- Në përputhje me Planin Vjetor të Punës dhe thirrjen publike të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka zhvilluar procesin e pranimit të aplikacioneve për përfitimin e subvencioneve në sektorin e blegtorisë.
- Thirrja publike për aplikim për subvencionimin e qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, si dhe për masat e tjera mbështetëse në blegtori, ka qenë e hapur në periudhën **15 janar – 27 shkurt 2026**.
- Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria ka pranuar, verifikuar dhe proceduar aplikacionet e fermerëve, të cilat më pas janë dorëzuar në MBPZHR për shqyrtim dhe realizimin e pagesave.
- Në total kanë aplikuar **90 fermerë**, sipas kategorive në vijim:
 - **76 fermerë** kanë aplikuar për subvencionimin e qumështit, me një sasi të përgjithshme prej **1,976,307 litra qumësht**.
 - **19 fermerë** kanë aplikuar për subvencionimin e **299 krerëve të viçave për majmëri**.
 - **1 fermer** ka aplikuar për subvencionimin e **53,054 brojlerëve**.
 - **1 fermer** ka aplikuar për subvencionimin e **126 krerëve për therje**.
- Drejtoria ka përmbushur me kohë obligimet e saj administrative, duke siguruar pranimin, verifikimin dhe procedimin e të gjitha aplikacioneve në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara nga MBPZHR.
- Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2025
- Pranimi i kërkesave të ndryshme, kryesisht për rregullimin e rrugëve fushore, ndërrim destinime, nifa.
- Pas kërkesave të shumta për dëme, zyrtarët e DBPZHR-së që kanë qenë pjesë e Komisioneve për vlerësimin e dëmeve kanë dalur në terren për vlerësimin e tyre.
- Vlera e Dëmeve në Bujqësi sipas kërkesave ka qenë **165,178.64 €**.
- Dëmet e shkaktuara nga vërshimet e muajit janar të këtij viti në rrugët fushore, urat dhe përroskat kanë qenë të konsiderueshme. Sipas vlerësimeve të bëra, vlera e përgjithshme e dëmeve arrin në rreth **130,000 €**.



Aktivitetet në muajin shkurt

Thirrja publike për bizneset grumbulluese dhe përpunuese të perimeve

- Në kuadër të programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve bujqësorë dhe bizneseve përpunuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka shpallur **Thirrjen Publike për aplikim** për të gjitha bizneset që merren me grumbullimin dhe përpunimin e perimeve, kryesisht të **trangullit kornishon dhe specit**, të cilat kanë treg të siguruar për plasimin e këtyre produkteve.
- Qëllimi i kësaj thirrjeje ishte lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset përkatëse, me synim krijimin e kushteve më të favorshme për prodhuesit bujqësorë dhe sigurimin e tregut për produktet e tyre.
- Në kuadër të kësaj mbështetjeje janë paraparë të mbulohen këto inpute bujqësore:
 - fidanë cilësorë të trangullit kornishon;
 - plehërimi bazë dhe riplehërimi (plehra kristalore);
 - produktet për mbrojtjen e bimëve (pesticide);
 - folia për mulçërim (folia e zezë);
 - sistemi I ujitjes pikë - pikë
- Thirrja publike ka qenë e hapur në periudhën **27.02.2026 – 13.03.2026**, gjatë së cilës bizneset e interesuara kanë pasur mundësi të aplikojnë në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në thirrje.
- Poashtu është formuar komisioni dhe është publikuar vendimi për përfituesin, si dhe është nënshkruar kontrata.



Vaksinimi i bagëtive të trasha

- Në kuadër të masave për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, veterinarit i punësuar në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka realizuar vaksinimin falas të bagëtive në territorin e komunës.
- Gjatë periudhës raportuese janë vaksinuar gjithsej **2,126 krerë bagëti të trasha** me vaksinën **Cubolac**, me qëllim të mbrojtjes së tyre nga sëmundjet infektive dhe ruajtjes së shëndetit të fondit blegtoral.
- Pas përfundimit të vaksinimit të bagëtive të trasha, Drejtoria do të vazhdojë me zbatimin e planit të vaksinimit edhe për **bagëtitë e imta**, duke synuar përfshirjen sa më të gjerë të fermerëve dhe garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes shëndetësore të kafshëve në komunë.



Raport mbi procesin e vaksinimit kundër Clostridiumit (CUBOLAC)

- Procesi i vaksinimit me vaksinën **CUBOLAC (Clostridium)** për lopët qumështore dhe viçat është zhvilluar në periudhën nga **05.02.2026** deri më **04.03.2026**, duke përfunduar me sukses.
- Gjatë realizimit të vaksinimit në terren nuk është shënuar asnjë incident. Megjithatë, disa ferma kanë refuzuar vaksinimin e gjedheve, deleve dhe dhive, pavarësisht informimit dhe vizitave të ekipit veterinar.
- Gjatë procesit të vaksinimit janë vizituar dhe vaksinuar gjithsej **99 ferma**.
- Sa i përket gjendjes shëndetësore të kafshëve, në gjedhët e komunës sonë sëmundjet që paraqiten më shpesh janë **tuberkulozi (TBC)**, **bruceloza**, **klostridioza (Clostridium)**, si dhe sëmundje të tjera infektive, të cilat monitorohen dhe trajtohen në përputhje me programet veterinarë në fuqi.

Mbikëqyrja e kontratave për shfrytëzimin e pronës komunale

- Në bazë të vendimit për formimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, komisioni i emëruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka zhvilluar inspektime në terren për të verifikuar zbatimin e obligimeve kontraktuale nga përfituesit.
- Gjatë inspektimeve janë kontrolluar të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim me vendim të Kuvendit Komunal, me qëllim të vlerësimit të mënyrës së shfrytëzimit të tyre dhe respektimit të kushteve të përcaktuara në kontratat përkatëse.
- Pas përfundimit të inspektimeve, komisioni ka hartuar raportin për të gjithë shfrytëzuesit e këtyre pronave. Në rastet ku janë konstatuar parregullsi ose mospërbushje e obligimeve kontraktuale, komisioni u ka dërguar vërejtje me shkrim shfrytëzuesve të pronave, duke kërkuar marrjen e masave për eliminimin e parregullsive dhe respektimin e plotë të kushteve të kontratës.
- Ky proces ka pasur për qëllim sigurimin e një shfrytëzimi të rregullt dhe efikas të pronës komunale, në përputhje me interesin publik dhe dispozitat e kontratave në fuqi.

Trajtimi i kërkesave të qytetarëve

- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka pranuar dhe trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash nga qytetarët dhe fermerët, në kuadër të kompetencave të saj.
- Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me:
 - rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore;
 - ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore;
 - si dhe çështje të tjera që lidhen me sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
- Të gjitha kërkesat e pranura janë shqyrtuar në afatet e përcaktuara, janë trajtuar sipas procedurave ligjore dhe administrative në fuqi dhe janë proceduar për shqyrtim ose vendimarrje në organet kompetente, sipas natyrës së secilës kërkesë.

Vizitat në terren dhe bashkëpunimi me fermerët

- Në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janë realizuar vizita të shumta në terren te fermerët, blegtorët dhe operatorët e ndryshëm ekonomikë që veprojnë në sektorin e bujqësisë.

Gjatë këtyre vizitave janë vizituar:

- ferma dhe stalla të fermerëve;
- fidanishte;
- sera;



- pika grumbulluese të produkteve bujqësore;
- si dhe subjekte të tjera që zhvillojnë veprimtari në sektorin e bujqësisë.
- Vizitat në terren kanë pasur për qëllim njohjen nga afër me gjendjen e fermerëve, mënyrën e zhvillimit të aktiviteteve të tyre bujqësore dhe sfidat me të cilat përballen gjatë procesit të prodhimit.
- Përmes këtyre takimeve dhe kontakteve të drejtpërdrejta me fermerët dhe blegtorët, Drejtoria është informuar për nevojat, kërkesat dhe problemet e tyre, me qëllim që në vazhdimësi të planifikohen dhe ndërmerren masa mbështetëse në përputhje me mundësitë dhe prioritetet e zhvillimit të sektorit të bujqësisë.



Aktivitetet në muajin mars

Përkrahja e fermerëve me pleh artificial

- Gjatë muajit mars 2026, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka shpallur **Thirrjen Publike për Përkrahjen e Fermerëve me Pleh Artificial**, me qëllim të mbështetjes së fermerëve dhe zvogëlimit të kostove të prodhimit bujqësor.
- Thirrja publike ka qenë e hapur në periudhën **02.03.2026 – 19.03.2026**, gjatë së cilës fermerët kanë pasur mundësi të aplikojnë për përfitim nga kjo masë mbështetëse.
- Në kuadër të kësaj thirrjeje kanë aplikuar gjithsej **1,146 fermerë**.
- Pas përfundimit të afatit të aplikimit, është formuar komisioni përkatës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara. Komisioni ka për detyrë të verifikojë përmbushjen e kritereve nga aplikuesit dhe, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, të përgatisë dhe publikojë listën e përfituesve sipas kritereve të përcaktuara në thirrjen publike.
- Ky projekt synon të ofrojë mbështetje direkte për fermerët dhe të kontribuojë në rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë.



Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor

Aktivitetet në muajin prill

Për zbatimin e projektit për mbështetjen e fermerëve me inpute bujqësore

- Me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe rritjes së prodhimit vendor, Komuna, në bashkëpunim me kompaninë Agro Celina, ka realizuar projektin për mbështetjen e fermerëve me inpute bujqësore për kultivimin e trangullit kornishon dhe specit Kërtosk.

Në kuadër të këtij projekti, fermerët përfitues mbështeten me:

- Fidane të trangullit kornishon;
 - Fidane të specit Kërtosk;
 - Plehra bazë;
 - Plehra për ri-plehërim (kristalore);
 - Produkte për mbrojtjen e bimëve (pesticide);
 - Folie të zezë për mulçërim;
 - Shporta për vjeljen e prodhimeve;
 - Sistem të ujitjes pikë-pikë;
 - Material për ambalazhimin e prodhimeve.
- 
- Në këtë iniciativë, Drejtoria e Bujqësisë subvencionon 80% të vlerës së projektit, ndërsa kompania Agro Celina kontribuon me 20%.
 - Në kuadër të projektit do të mbështeten gjithsej **150 fermerë**, të cilët do të përfitojnë rreth **500,000 fidane**. Këto fidane do të mbillen në një sipërfaqe të përgjithshme prej **12 hektarësh**, ku **7 hektarë** do të kultivohen me **tranguj kornishon**, ndërsa **5 hektarë** me **speci Kërtosk**.
 - Përzgjedhja e përfituesve është bërë në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Pas përfundimit të të gjitha procedurave administrative dhe ligjore, ka filluar edhe shpërndarja e inputeve bujqësore për fermerët përfitues.
 - Ky projekt synon të përmirësojë kushtet e prodhimit, të rrisë rendimentin dhe cilësinë e kulturave bujqësore, të ulë kostot e prodhimit për fermerët dhe të ndikojë në rritjen e të ardhurave të tyre, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në komunë.
 - Drejtoria e Bujqësisë do të vazhdojë monitorimin e zbatimit të projektit dhe do të ofrojë mbështetje teknike për fermerët gjatë gjithë sezonit të prodhimit

Përkrahje e fermerëve me pleh artificial, faza e parë shpërndarja e plehut

- Drejtoria e Bujqësisë ka vazhduar zbatimin e projektit për mbështetjen e fermerëve me pleh artificial, me qëllim të uljes së kostove të prodhimit bujqësor dhe rritjes së rendimentit të kulturave bujqësore.
- Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve nga komisioni përkatës, fermerët që kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në Thirrjen Publike për Aplikim me nr. të protokollit 1025, të datës 02.03.2026, janë shpallur përfitues të mbështetjes. Përfituesit janë verifikuar edhe përmes programit ELPIS të subvencioneve për vitin 2025.
- Në kuadër të këtij projekti, gjithsej **1,130 fermerë** janë shpallur përfitues të plehut artificial. Për shkak të numrit të madh të përfituesve dhe organizimit të procesit të shpërndarjes, realizimi i projektit është ndarë në **dy faza**.
- Në fazën e parë është publikuar lista e përfituesve, të cilët janë njoftuar për kryerjen e participimit prej **20%**, në përputhje me kushtet e projektit. Pas përfundimit të pagesave të participimit, është bërë edhe shpërndarja e plehut artificial, ku **423 fermerë** janë furnizuar me sukses me sasinë e plehut sipas listës së fazës së parë.
- Gjatë muajit maj do të publikohet edhe lista e përfituesve të **fazës së dytë**. Fermerët e kësaj faze janë në proces të kryerjes së participimit prej **20%**, ndërsa pas përfundimit të këtij procesi do të njoftohen me kohë për datën, vendin dhe mënyrën e shpërndarjes së plehut artificial.
- Drejtoria e Bujqësisë do të vazhdojë zbatimin e projektit deri në përfundimin e shpërndarjes së plehut për të gjithë përfituesit, duke siguruar transparencë dhe respektim të procedurave të parapara.



Aktivitetet në muajin Maj

Vaksinimi i bagëtive të imta kundër sëmundjeve infektive

- Në kuadër të aktiviteteve të Drejtorisë së Bujqësisë për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbështetjen e sektorit të blegtorisë, gjatë muajit maj 2026 është realizuar fushata e vaksinimit të bagëtive të imta (dele dhe dhi) me vaksinën CUBOLAC (Clostridium).
- Vaksinimi është kryer nga veterinaritë të angazhuar nga Komuna, me qëllim të parandalimit të sëmundjeve infektive dhe ruajtjes së shëndetit të fondit blegtoral në territorin e komunës.
- Gjatë kësaj fushate janë vaksinuar gjithsej 7,320 krerë dele dhe dhi, të shpërndara në 29 ferma. Procesi i vaksinimit është zhvilluar sipas planit të paraparë dhe ka përfunduar me sukses, pa u evidentuar incidente gjatë realizimit në terren. Një numër i vogël fermerësh kanë refuzuar vaksinimin e kafshëve të tyre.
- Shërbimi i vaksinimit është ofruar falas për të gjithë fermerët, ndërsa të gjitha shpenzimet për furnizimin me vaksinë dhe realizimin e procesit janë mbuluar nga Komuna, në kuadër të mbështetjes institucionale për zhvillimin e blegtorisë dhe zbatimin e masave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve.
- Ky aktivitet ka kontribuar në uljen e rrezikut nga përhapja e sëmundjeve infektive, në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të bagëtive dhe në rritjen e sigurisë së prodhimit blegtoral në territorin e komunës.



Raport I veterinarit, mbi realizimin e vaksinimit të deleve dhe dhive me vaksinën CUBOLAC (Clostridium)

- Procesi i vaksinimit të deleve dhe dhive me vaksinën CUBOLAC (Clostridium) është zhvilluar në periudhën 06.05.2026 – 25.05.2026 dhe ka përfunduar me sukses, sipas planit të paraparë.
- Gjatë realizimit të aktivitetit në terren nuk është shënuar asnjë incident apo problem që do të pengonte mbarëvajtjen e procesit të vaksinimit. Megjithatë, një numër i vogël fermash kanë refuzuar vaksinimin e deleve dhe dhive të tyre, pavarësisht informimit dhe këshillimit nga stafi veterinar.
- Në kuadër të këtij procesi janë vizituar dhe vaksinuar gjithsej 29 ferma në territorin e komunës.
- Sa i përket gjendjes shëndetësore të tufave, sëmundjet që paraqiten më shpesh te delet dhe dhitë në territorin e komunës janë **Brucelloza** dhe sëmundjet e shkaktuara nga **Clostridiumi**, ndërsa monitorimi dhe masat parandaluese vazhdojnë në mënyrë të rregullt, në përputhje me programin e shëndetit të kafshëve.
- Në përgjithësi, procesi i vaksinimit është realizuar me sukses dhe ka kontribuar në forcimin e masave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të deleve dhe dhive në territorin e komunës.

Përkrahja e fermerëve me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA"

- Gjatë muajit maj, Drejtoria e Bujqësisë ka shpallur Thirrjen Publike për projektin "Përkrahja e fermerëve me preparate për luftimin e insektit 'Cikadia' dhe trajtim me dron në vreshtat e hardhisë së rrushit".
- Thirrja ka qenë e hapur nga **18.05.2026** deri më **01.06.2026**. Për shkak të problemeve teknike në sistemin e lëshimit të vërtetimit për tatimin në pronë, afati për aplikim është zgjatur deri më **12.06.2026**, me qëllim që të gjithë fermerët e interesuar të kenë mundësi të aplikojnë.
- Pas përfundimit të procedurave të vlerësimit të aplikacioneve dhe verifikimit të përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike, **310 fermerë** janë shpallur përfitues të projektit.
- Përfituesit janë furnizuar me preparatet për luftimin e insektit "**Cikadia**", me qëllim të mbrojtjes së hardhisë së rrushit nga dëmtuesit dhe përmirësimit të shëndetit të kulturës.
- Ky projekt synon të mbështesë vreshtarët në mbrojtjen e prodhimit, të zvogëlojë dëmet e shkaktuara nga insektet dhe të kontribuojë në rritjen e cilësisë dhe rendimentit të prodhimit të rrushit në territorin e komunës.
- Projekti sperkatje me dron është ende në fazën tenderuese.



Aktivitet në muajin Qershor

Faz e Dytë e Projektit për Përkrahjen e Fermerëve me Pleh Artificial

- Në kuadër të politikave të Komunës për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe rritjen e prodhimit të bujqësorë, më 05.06.2026 ka filluar zbatimi i Fazës së Dytë të Projektit për Përkrahjen e Fermerëve me Pleh Artificial.
- Gjatë kësaj faze kanë përfunduar gjithsej 700 fermerë, të cilët janë furnizuar me 5,600 thasë pleh artificial, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga projekti.
- Projekti është realizuar sipas modelit të bashkëfinancimit, ku:
 - Komuna ka mbuluar 80% të vlerës së plehut artificial;
 - Fermerët kanë participuar me 20% të vlerës.
- Shpërndarja e plehut artificial është përfunduar me sukses dhe të gjithë fermerët përfundues, të cilët kanë kryer obligimin e participimit prej 20%, kanë pranuar sasinë e plehut artificial sipas planifikimit.
- Realizimi i kësaj faze ka kontribuar në mbështetjen e fermerëve, uljen e kostos së prodhimit bujqësor dhe krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore në territorin e komunës.



Projektet e investimeve kapitale

- Gjatë periudhës, Janar – Qershor 2026 janë rregulluar dhe rrafshuar rreth 8.5 kilometra rrugë fushore, të cilat kishin qenë të pakalueshme dhe të dëmtuara si pasojë e vërshimeve të muajit janar. Këto punime janë realizuar falë ndihmës vullnetare të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e infrastrukturës rrugore fushore.
- Jemi të vetëdijshëm se ekziston nevoja për rregullimin dhe shtrimin e një numri më të madh të rrugëve fushore. Megjithatë, gjatë vitit 2026 janë paraqitur një sërë pengesash që kanë ndikuar në realizimin e projekteve kapitale në komunën tonë. Fillimisht, alokimit i buxhetit deri në fund të muajit prill ka vonuar fillimin e investimeve. Po ashtu, tërheqja e mjeteve nga Thesari i Shtetit për shkak të zbatimit të kontratës kolektive ka kufizuar më tej mundësitë financiare të komunës.
- Si rezultat i këtyre rrethanave, realizimi i projekteve kapitale gjatë këtij viti është zhvilluar me vështirësi. Pavarësisht këtyre sfidave, komuna do të vazhdojë angazhimin për përmirësimin e infrastrukturës rrugore fushore, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe prioritetet e përcaktuara.
- Të gjitha këto punime në rrugë dhe pastrime të përrrenjve janë realizuar në kuadër të fazës emergjente, të paraparë pas vërshimeve të janarit.

Rregullimi i rrugëve fushore

- Gjatë kësaj periudhe ka qenë e mundur të ndërhyhet vetëm në ato rrugë fushore që kanë qenë të pakalueshme për mjetet bujqësore. Pas inspektimeve dhe verifikimeve të kryera në terren nga zyrtarët përkatës, është konstatuar se këto rrugë ishin në gjendje të rënduar dhe nuk mundësonin qarkullimin normal të mjeteve bujqësore.
- Për këtë arsye, ndërhyrjet janë fokusuar në rregullimin dhe rrafshimin e rrugëve më prioritare, me qëllim të rikthimit të qasjes në parcelat bujqësore dhe lehtësimit të zhvillimit të aktiviteteve bujqësore.
- Janë rregulluar këto rrugë fushore:
 - Sanimi i rrugëve fushore në fshatin **Polluzhë**, në lokacionin “Livadhet e Morinëve”,
 - Sanimi i rrugëve fushore në fshatin **Drenoc**, te Kroi i Demirit, si dhe në rrugën Zhagavica.



- Sanimi i rrugëve fushore në rrugët e vreshtave në **Rahovec** në zonat **Hamoc, Bernjak dhe te shtavica**, ku gjendja ka qenë e vështirë dhe në disa raste rrugët të pakalueshme.
- Sanimi i rrugëve fushore në fshatin **Celinë**.
- Sanimi i rrugëve fushore në fshatin në fshatin **Radostë**.



Pastrimi i Përrenjëve

- Gjatë periudhës janar–qershor 2026 janë pastruar 9.7 kilometra kanale kulluese dhe përrenj. Shumica e kanaleve të kullimit për tokat bujqësore ishin bllokuar me mbeturina dhe materiale të depozituara si pasojë e vërshimeve të muajit janar të këtij viti.
- Drejtoria e Bujqësisë, në kuadër të kontratës ekzistuese të nënshkruar në vitin 2025, ka ndërhyrë për pastrimin dhe hapjen e këtyre kanaleve, duke mundur rrjedhjen normale të ujit dhe duke kontribuar në mbrojtjen e tokave bujqësore nga përmytjet dhe dëmet e mundshme.
- Ky projekt do të vazhdojë edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit 2026, me qëllim të përmirësimit të sistemit të kullimit dhe sigurimit të mbrojtjes së vazhdueshme të tokave bujqësore në territorin e komunës.



- ✓ Punimet janë zhvilluar në fshatin **Zaqisht**, ku ekipet në terren e kanë kryer pastrimin e shtratit të përrenjve, me qëllim të mirëmbajtjes së rrjedhës së ujërave dhe parandalimit të vërshimeve.
- ✓ Punimet janë zhvilluar në fshatin **Xërxë**, ku ekipet në terren kanë kryer pastrimin e shtratit të përrenjve, me qëllim të mirëmbajtjes së rrjedhës së ujërave dhe parandalimit të vërshimeve.
- ✓ Kemi realizuar punimet në **Rahovec** rrugës për **Brestovc**, ku është bërë pastrimi i një përrua që ishte bllokuar nga mbeturinat dhe ujërat e zeza.
- ✓ Në kuadër të projektit për pastrimin e përrenjve dhe kanaleve të kullimit të tokave bujqësore, Drejtoria e Bujqësisë e Komunës së Rahovecit ka intervenuar edhe në kanalën e kullimit në fshatin **Celinë**.

Sanimin e urave të dëmtuara nga vërshimet e muajit janar

- Si pasojë e vërshimeve të ndodhura gjatë muajit janar, në disa zona të komunës janë dëmtuar urat në rrugët fushore, duke vështirësuar qarkullimin e fermerëve dhe qasjen në parcelat bujqësore.
- Me qëllim të rikthimit të infrastrukturës në funksion dhe lehtësimit të aktivitetit bujqësor, Drejtoria kompetente ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për sanimin e urave të dëmtuara.
- Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë rehabilituar gjithsej **6 ura** në rrugët fushore, të cilat ishin dëmtuar nga vërshimet. Punimet kanë përfshirë riparimin e konstruksioneve të dëmtuara, stabilizimin e bazamenteve dhe ndërhyrjet e nevojshme për të siguruar funksionalitetin dhe përdorimin e sigurt të urave.
- Me përfundimin e këtyre punimeve është mundësuar rikthimi i qarkullimit normal në rrugët fushore, duke përmirësuar qasjen e fermerëve në tokat bujqësore dhe duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore.
- Drejtoria do të vazhdojë monitorimin e gjendjes së infrastrukturës rurale dhe, sipas nevojës, do të ndërmarrë masa të tjera për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sa



Kanalet Kulluese

- ✓ Pas reshjeve të fundit dhe grumbullimit të ujit në tokat bujqësore në fshatin **Xërxë**, Ekipet tona në terren kanë intervenuar me mjete dhe mekanizëm për pastrimin e kanaleve kulluese dhe hapjen e rrjedhës së lirë të ujit, me qëllim parandalimin e dëmeve në kulturat bujqësore dhe rikthimin e kushteve normale për punimin e tokës.
- ✓ Kemi punuar në pastrimin e kanalit të kullimit në fshatin **Fortesë**.
- ✓ Kemi intervenuar në kanalin e kullimit ndërmjet fshatit **Fortesë** dhe fshatit **Celinë**.
- ✓ Kemi punuar në pastrimin e kanalit të kullimit në fshatin **Senoc**.



Depo Bujqësore

- Në bazë të kontratës së nënshkruar gjatë vitit 2025, është duke u realizuar projekti "**Ndërtimi dhe rregullimi i depos bujqësore**", i cili financohet nga kategoria e investimeve kapitale.
- Zbatimi i këtij projekti ka pësuar vonesa për shkak të disa faktorëve objektivë. Fillimisht, buxheti komunal është alokuar me vonesë, respektivisht në fund të muajit prill të këtij viti. Po ashtu, vonesa janë shkaktuar edhe nga tërheqja e mjeteve nga Thesari për shkak të obligimeve që kanë rrjedhur nga zbatimi i Kontratës Kolektive.
- Pavarësisht këtyre vështirësive, punimet kanë filluar dhe janë duke vazhduar sipas dinamikës së mundësuar nga kushtet financiare. Besojmë se projekti do të përfundojë me sukses dhe do të finalizohet brenda afateve të mundshme.



Subvencionet

- Pas shpalljes së thirrjes nga Ministria e Bujqësisë për subvencionimin e fermerëve, Drejtoria për Bujqësi ka filluar menjëherë përgatitjet dhe ka njoftuar të gjithë fermerët e komunës sonë që të aplikojnë brenda afatit të përcaktuar nga ministria, nga **22.06.2026 deri më 21.07.2026**.
- Procesi i aplikimit është duke vazhduar sipas planit dhe dinamikës së paraparë. Me qëllim të përmbylljes së këtij procesi brenda afatit ligjor dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase, kemi angazhuar edhe staf shtesë nga drejtoritë e tjera komunale.
- Për t'u ardhur sa më afër fermerëve dhe për t'ua lehtësuar procedurat e aplikimit, përveç zyrave në komunë, shërbimet po ofrohen edhe në dy lokacione të tjera, në **Krushë të Madhe** dhe **Ratkoc**, duke u mundësuar fermerëve qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në procesin e aplikimit.
- Bazuar në planin e punës dhe dinamikën e deritanishme, presim që procesi i aplikimit të përfundojë me sukses brenda afatit të përcaktuar nga Ministria, duke siguruar që të gjithë fermerët e interesuar të kenë mundësinë të përfitojnë nga skema e subvencionimit.

Informatë lidhur me procesin e korrje-shirjeve të drithërave të bardha

- Procesi i korrje-shirjeve të drithërave të bardha në komunën tonë ka filluar zyrtarisht më **29.06.2026** dhe është duke vazhduar sipas planifikimit.
- Sipas të dhënave të Drejtorisë për Bujqësi, këtë vit në territorin e komunës janë të mbjella rreth **2,800 hektarë me grurë**, të cilët janë përfshirë në procesin e korrje-shirjeve.
- Për mbarëvajtjen e këtij procesi, Drejtoria për Bujqësi ka formuar Shtabin për Korrje-Shirje, i cili është i angazhuar çdo ditë në terren. Shtabi mban komunikim të vazhdueshëm me kryetarët e këshillave të fshatrave, fermerët dhe operatorët e kombajnave, me qëllim të koordinimit të punëve dhe zgjidhjes në kohë të çdo çështjeje që mund të paraqitet gjatë sezonit.
- Sipas të dhënave të deritanishme, çmimi i shërbimit të korrjes me kombajnë sillet nga **130 deri në 140 euro për hektar**.
- Bazuar në vlerësimet paraprake nga terreni, pritet që rendimenti mesatar i grurit të jetë rreth **5,000 kilogramë për hektar**, nëse kushtet mbeten të favorshme deri në përfundim të korrje-shirjeve.
- Drejtoria për Bujqësi do të vazhdojë monitorimin e vazhdueshëm të procesit dhe do të jetë në shërbim të fermerëve deri në përfundimin e plotë të korrje-shirjeve, me qëllim që ky sezon të përmbyllet me sukses.



PËRFUNDIM

Përmbyllje e raportit informues

- Ky raport përmbledhës paraqet aktivitetet dhe angazhimet kryesore të Drejtorisë për Bujqësi gjatë kësaj periudhe raportuese.
- Gjatë kësaj periudhe, zyrtarët e drejtorisë kanë qenë vazhdimisht të gatshëm për vlerësimin e dëmeve që u janë shkaktuar fermerëve të komunës sonë nga fatkeqësitë natyrore. Në çdo rast të paraqitjes së dëmeve në kulturat bujqësore, ekipet kanë dalë në terren me kohë për të bërë vlerësimet e nevojshme.
- Po ashtu, zyrtarët kanë qenë në shërbim të fermerëve për çdo kërkesë dhe nevojë të tyre, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm dhe duke ofruar mbështetje profesionale pa hezitim.
- Të gjitha këto aktivitete janë realizuar falë angazhimit dhe përkushtimit të stafit të Drejtorisë për Bujqësi. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm se gjithmonë ka hapësirë për të punuar edhe më shumë. Synimi ynë mbetet që të jemi sa më afër fermerëve tanë dhe t'u ofrojmë mbështetje në çdo kohë.
- Një nga sfidat kryesore me të cilat përballemi është fakti se Komuna jonë ka një buxhet relativisht të vogël në krahasim me komunat e tjera, ndërkohë që numri i fermerëve është ndër më të lartët në vend. Kjo e bën edhe më sfidues planifikimin dhe realizimin e mbështetjes për sektorin e bujqësisë, duke ndikuar edhe në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori në komunën tonë.
- Pavarësisht këtyre sfidave, mbetemi të përkushtuar që, në kuadër të mundësive buxhetore dhe ligjore, të jemi pranë fermerëve tanë. Jemi krenarë që komuna jonë ka ndër fermerët më punëtorë dhe më të përkushtuar në nivel vendi, të cilët meritojnë mbështetjen dhe respektin tonë të vazhdueshëm.

Me respekt,

13. 07. 2026

Rahovec

